



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3412/ 16 prot.,

Datë 06 .05.2025

**V E N D I M**  
**Nr. 629 /2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |         |
|------------------|---------|
| Jonaïd Myzyri    | Kryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar  |
| Gjergj Mersini   | Anëtar  |

Në mbledhjen e datës 06 .05.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:**

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 231/2025, datë 12.02.2025 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me nr. REF-24856-10-16-2024, me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 Lekë *pa TVSH*, zhvilluar më datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Erisoni Company”, me Nipt K92006501A me adresë: *Lagjja 6, Rruga “Shoqëria Bashkimi”, Pallati Clas, Kati i parë, Durrës.*

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Kamëz  
*Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë*

**Subjekte të Interesuara:**

*“ADD Group” SHPK, me NIPT L81722022V. me adresë: Kamëz, Rruga "Bulevardi Nënë Tereza", Bashkia Kamëz, Nr. pasurie 9/22 dhe ZK 2066.*

**Baza Ligjore:**

*Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:****I***Rrethanat e çështjes***Vendos:**

1.Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK për procedurën e prokurimit REF-24856-10-16-2024, me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 Lekë *pa TVSH*, zhvilluar më datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Add group” SHPK sipas konstatimeve të vendimit të Komisionin e Prokurimit Publik .

3.Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4.Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Erisoni Company”shpk .

3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

4.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1.2 Me shkresën nr. 2006/2 prot., datë 24.04.2025, protokolluar me tonën nr. 3412/13 prot., datë 28.04.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz lidhur me zbatimin e vendimit nr.231/2025, datë 12.02.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipër përmendur, duke bërë rivlerësimin e procedurës për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me nr. Loti II-të: Blerje printera, me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz si dhe gjithashtu bashkë lidhur ka përcjellë dhe shkresën me nr. 2006 prot., datë 28.02.2025 “Procesverbal” me lëndë: “ Mbi verifikimin e dokumentacionit të OE “Add group” SHPK” .

I.3. Me shkresën nr. 2006/2 prot., datë 24.04.2025, protokolluar me tonën nr. 3412/13 prot., datë 28.04.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz lidhur me zbatimin e vendimit nr.231/2025, datë 12.02.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipër përmendur, duke bërë rivlerësimin e procedurës për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz si dhe gjithashtu bashkë lidhur ka përcjellë dhe shkresën me nr. 2006 prot., datë 28.02.2025 “Procesverbal” me lëndë: “ Mbi verifikimin e dokumentacionit të OE “Add group” SHPK” .

Gjithashtu në shkresën nr. 2006/2 prot., datë 24.04.2025, protokolluar me tonën nr. 3412/13 prot., datë 28.04.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz kërkon heqjen e procedurës së prokurimit nga pezullimi.

## **II**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

### **Arsyeton**

II.1 Me shkresën nr. 2006/2 prot., datë 24.04.2025, protokolluar me tonën nr. 3412/13 prot., datë 28.04.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz lidhur me zbatimin e vendimit nr.231/2025, datë 12.02.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipër përmendur, duke bërë rivlerësimin e procedurës për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz. Bashkëlidhur shkresa me nr. 2006 prot., datë 28.02.2025 “Procesverbal” me lëndë: “ Mbi verifikimin e dokumentacionit të OE “Add Group” SHPK”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të ardhur nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, , konstatohet se autoriteti kontraktor ka bërë rivleresimin për procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit KPP Nr.231/2025, datë 12.02.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

- 1.Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” REF-24856-10-16-2024, me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 Lekë *pa TVSH*, zhvilluar më datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
- 2.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

